

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-62208 dt. 23.10 2019

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
26.09.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 26.09.2019

Mbledhjen e kryesoi: Labinot HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin anëtarë 25 asambleistë

Kuvendi filloi punimet më këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 20.07.2019.
2. Propozim vendim i buxhetit Komunal për vitet 2020- 2022.
3. Propozim Vendim për ndryshimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete.
4. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar – Qershor 2019.
5. Propozim vendim për plotësimin e ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë.
6. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
7. Prezantimi dhe aprovimi i anëtarëve nga Komisionet e tri Komiteteve Konsultative për konkurrentët e përzgjedhur në bazë të Konkurseve
8. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj deklaroi fillimin e mbledhjes së rregullt të datës 26.09.2019 ku prezent janë 25 deputetë, 5 pa kartel, si dhe Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi dhe përfaqësues të OSCE-së, KDI-së si dhe drejtorët e drejtorive përkatëse. Të nderuar, përshëndetje për të gjithë. Jemi në mbledhjen e rregullt të Kuvendit dhe për dallim nga herët e tjera ku transmetimi është bërë direkt, tash nuk mundemi që këtë seancë ta transmetojmë direkt si rezultat i teknikës së Kuvendit si rezultat i furnizimit me rryt dhe ytuben ku kontraktues është qeveria, nuk jemi na.

Unë e uroj z. Hasi në pozitën e nënkryetarit dhe që po merr pjesë në këtë seancë. Uroj që të kesh punë të mire dhe suksese gjatë kësaj periudhe në qeverisjen Lladrovci. Edhe zotin Nika e uroj për zgjedhjen në Këshillin e Përgjithshëm suksese.

Atëhere besoj se të gjithë jeni njoftuar me rendin e ditës.

I nderuar Kryetar, kabinet i Kryetarit Asambleista. A jeni për këtë rend dite! Ju lutem votoni. Atëhere 21 janë për, 1 abstenim, 1 kundër, 2 të tjerët s'kanë votuar. Kalon. **Kalojmë në pikën 1;** Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt.

20.07.2019. Ju ftoj për diskutim lidhur me procesverbalin, nëse s'ka kalojmë në votim. 24 për asnjë kundër asnjë abstenim kalon kjo pike.

Kalojmë në pikën 2; Propozim vendim i buxhetit Komunal për vitet 2020- 2022. Para se me shku në diskutim drejtori do ishte mirë me na bë një prezantim në vija të trasha të këtij propozim vendimi.

Drejtori për buxhet Shyqyri Bublaku; Ju faleminderit asambleista! Siç e dini pika e parë për sot është Propozim vendim i buxhetit për vitet 2020- 2022. Ju e keni materialin përpara. Unë e kisha shku veç në pika të shkurtëra. Si bazë për hartimin e këtij buxheti ka qenë qarkorja e nivelit qendror e Qeverisë së Kosovës gjegjësisht Ministrisë së Financave, e cila na i ka përcaktuar kufijtë buxhetor për vitin 2020-21-22.

Kufijtë e përcaktuar kanë qenë, po nisna prej stafit.

Buxheti i çertifikum për komunë e Drenasit është për 1325 punëtorë.

Buxheti i çertifikum për paga ka qenë 9 544 810 euro dmth ky është buxheti për paga dhe mëditje.

Buxheti për mallra e shërbime ka qenë 1 793 263 euro.

Buxheti për shpenzime komunale ka qenë 195 340 euro.

Subvencione dhe transfere kemi buxhetin prej 270 000 euro.

Buxheti për shpenzime kapitale është 4 686 930 euro.

Dmth buxheti i përgjithshëm për vitin 2020 është 16 490 343 euro.

Këtij buxheti ne duhet ti përmbahemi dhe si shkas kemi tejkalime në kategorinë paga dhe shpenzime për mëditje, për shkak të ligjit për paga, i cili është aprovu në muajin mars, ka dale në Gazetën Zyrtare po në mars, ku minusi i paraqitur e keni edhe informatën shtesë ku ja u kemi paraqitur këtë pikë është 456 261euro. Këtë problem e kanë të gjitha komunat sepse kur është bërë ligji për pagat nuk është planifikuar kontributi pensional i punëdhënësit që është 5% e që është diku në vlerë për 456 000 euro dhe përvoja e punës e cila kap shumë 523000 euro.

Më pas Bublaku vijoi me shifrat minuse sipas drejtorive dhe shinformacione të tjera buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj; E hapim temën për diskutim fjala për për z. Gashi

Petrit Gashi; Përshëndetje të nderuar! Fatkeqësisht po vazhdon ndarja e buxhetit për investime kapitale përsëri diskriminuese për shumicën e fshatrave, të cilat tash e 20 vite kanë mbetur edhe pa pjesën kryesore të infrastrukturës. Unë pash vetëm në fshatin tim, në Llapushnik

Poterkë edhe Llukovcë janë ndarë vetëm 30 000 uro për rrjetin e asfaltimit. Ne e dimë se sa ka nevojë për infrastrukturë ajo pjesë, ose pash diçka tjetër psh. asfaltimi i rrugës Llapushnik - Berishë ishte 5000 euro. Për tre vjet keni planifikuar nga 5000 euro dmth 15000 euro dhe unë nuk e di se qysh asfaltohet rruga me ato fonde prej Llapushnikut në Berishë.

Tek kanalizimi i ujrave të zeza. E planifikoni gypin qëndror për lidhje në kolektor, prej Arllati ndërsa pjesa më e madhe Llapushnik, Arllat Gjyrgjicë Negrovci etj etj ka pesë herë tejkalim të shumës që duhet dhënë për të lidhur rrjetin e kanalizimit. Nqs ne e vendosim vetëm për një pjesë dhe pjesa tjetër mbetet mbi tokë atëherë ne skemi bërë kurrgjë. Psh në Llapushnik, Idrizi është njoftum për këtë se janë më shumë 4-5 mijë metra kanalizim që duhet me u bë. Janë gjashtë lagje që nuk janë lidhur me rrjetin e kanalizimit, S'po flasim për asfaltimin e rrugës që është tepër minimalë për një fshat aq i madh sa është Llapushniku. Ose të katër fshatrat që keni përfshirë, Arllat, Gjyrgjicë, Bytyç dhe Negrovci. Pra duhet të bëhet një ndarje kapitali sipas nevojave. Ejani dhe dilni në terren në fshatin Llapushnik dhe i shikoni nevojat sesa të mëdhaja janë. Janë distrikti i dytë i rrugës dmth. që tash veç e keni fillu në distriktin e parë. Ende nuk janë asfaltuar Zeqir Gashi që vetëm kjo shumë që keni planifikuar as atë rrugë nuk e mbulon. Pa folur për rruga "Shqiponja", rruga "Burim Gashi" rruga "Tri Dëshmorët". Është distrikti i dytë rruga, Mentor Gashi dmth të gjitha janë pa u rregullu. Ju vetë keni premtuar se brenda një mandati do ti plotësojmë ato. Me këtë buxhet edhe për 20 vite nuk keni mundësi ti kryeni këto premtime pra edhe për 20 vitet e ardhshme infrastruktura e atyre fshatrave nuk përfundojnë. Ndaj kërkoj sqarime dhe ndarje të saktë të buxhetit, sipas nevojave konkrete të fshatrave.

Kryetari Ramiz Lladrovci; Faleminderit Petrit shqetësimet tuaja qëndrojnë, por ne si komunë i kemi ndjekur krejt procedurat. Unë nuk po flas për infrastrukturë rrugore në Llapushnik se në Llapushnik në këto dy vjet kërkon edhe më shumë. Ne jemi në bashkëfinancim është një kod që e përcaktojmë bashkëfinancim për me marrë fonde qendrore sepse nuk kemi parë për me nda për Berishë sepse kemi prioritet dhe punë më të mëdha. Sa i përket ujërave të zeza në Arllat e Llapushnik, ne jemi tash duke bë. Ne jemi duke ecur dhe nuk do të ketë më ujëra të zeza në sipërfaqe por do të futen në kolektorë dhe do të arrijmë deri te Guri i Plakës me kolektorë. Të gjitha këto po realizohen nga grantet që kemi fituar si komunë për shkak të performancës së mirë për transparencë dhe vetëm këtë vit kemi fituar rreth 700 000 euro grante. Më vjen keq për 22 fshatra që kanë mbetur pa ujë që nga qershori që ua kemi planifikuar por që kompanitë i kanë marrë paratë dhe gypi e ka ngrënë mini, nuk egziston fare gypi nga Ferronikeli e deri Kamenicë.

Petrit Gashi; Po pajtohem me shumicën. Ju po thoni kemi me ba gypin qendror prej Negrovci që është projekti më i mirë për ujërat e zeza. Po si do ti bëjmë kur mungojnë gypat e ujërave të zeza. I kemi nda 30-40 mijë euro për ujërat e zeza dhe po ti përmendi vetëm disa lagje. Lagjja Haradinaj i ka 800 metra kanalizime për tu lidhur me gypin kryesor, lagjja Tahiraj i ka edhe 550 metra kanalizime plus një pjesë që është në projekt të tyre. Gypi qendror për tu lidhur poshtë deri te lumi duhen edhe 450 metra me u zgjat, Lagjja Musaj i ka edhe 500 metra, tri pjesë te lagjja Thaçi i kanë edhe 1100 metra, tri gropa septike që duhen lidhur me to dhe duhen zgjatur gypat deri aty etj. Si do ti realizojmë ato.

Kryetari Ramiz Lladrovci; Petrit po i përziën temat. Po flasim për buxhetin e vitit 2020 dhe projektet janë të vitit 2019. Ne jemi duke i realizuar, të paktën ato lagje që e kanë kryer të mos i derdhin ujërat e zeza jashtë, por në kolektor. Ne buxhetin e kemi 4.6 milion dhe sivjet e kemi 1 milion më pak se vjet, por shpresojmë se shumë do të marrim buxhet se ne nuk kemi kandidat por kemi kryeministër Kadri Veselin.

Drejtori Idriz Hyseni; Kisha pas një sqarim sa i përket kanalizimit. Ne gjatë këtij viti presim të përfundojmë kolektorët, por kemi pritur lumenjtë ti pastrojmë dhe ti drejtojmë dhe si rezultat prej Negrovci e deri në Vukovc vjen gypi kryesor, kolektori. Në atë gyp nuk mund të lidhen sivjet, as vitin e ardhshëm nuk mund të lidhen. Ne e kemi qëllim, por nuk mund ti derdhim ato, faktikisht do të mbeten aty ku janë edhe vitin e ardhshëm, kur të mbarojë impiantit te Guri i Plakës atëherë do të bëhet kyçja. Për këtë arsye gjatë këtij viti bëjmë degëzimin që vjen prej Negrovci komplet deri në Vukovc, deri tek kolektori rreth lumit, që janë prej Nekovcit deri tek ura e gjimnazit. Këtë vit janë shpallur dhe pritet të lidhen kontratat. Kanë ec pastrimi dhe drejtimi i shtratit të lumit, ndaj nuk e kemi parë të arsyeshme shtimin e mjeteve të tjera. Shumicë e pareve i kemi hedhur tek kolektori rreth 420 000 euro. Sa i përket rrugëve sivjet janë duke përfunduar rrugët në Llapushnik, Potërk, Vukovc, janë tri fshatra apo lagje si me i qujt të Llapushnikut me ato investime mund ti përfundojmë. Dy vitet që kemi investu janë afruar shumë nuk janë përfunduar por janë gati barazuar me fshatrat e tjera.

Kryetari Ramiz Lladrovci; Nuk e përjashtojmë mundësinë për të marrë fonde nga niveli qendror dhe mund ti realizojmë. Unë i kam mbajtur premtimet më shumë në Llapushnik me mbikalimet që si keni parë kurrë, por janë një pjese që janë mësuar me shantazhu komunën. Dy fish më shumë kemi punuar në Llapushnik, por rendësi ka që të bashkëpunojmë dhe në fund të fundit aq buxhet kemi dhe jemi munduar të bëjmë sa mundemi.

Petrit Gashi; Kryetar ne vitin 2016 kur kemi biseduar në Llapushnik ke premtuar se për dy vjet e gjysem e kryejmë dhe akoma as ka mundësi për tu kryer. Une di që ska pasur investime , edi qe keni bërë një punë të mirë, por jeni shumë larg këtyre premtimeve.

Drejtori Shyqyri Bublaku; Kisha kërkua prej juve mirëkuptim, se në raportin e investimeve kapitale që e keni para jush është një projekt kapitale dhe intervenime emergjente dhe në bazë të rekomandimeve të auditorit Intervenimet emergjente janë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje Civile Emergjente, nuk hyjnë në investime kapitale, ndaj kemi kërkuar që të ndërrohet dhe të hiqet shuma e njëjtë 10 000 euro të mbartet te rrethimi, rregullimi i varrezave të Drenasit.

Kryesuesi fjala për ju z. Bylykbashi.

Sokol Bylykbashi; Propozim vendimi për buxhetin e vitit 2020 nuk na premtonte shumë për diskutime, pasi ka diçka që i mungon këtij projekti. Nuk ka saktësi sidomos në investimet e projekteve kapitale. Unë e kuptoj përfshirjen e dy tri fshatrave në një kod për shkak të lehtësimit procedurave. Mungon saktësi në projekt buxhet, për një rrugë, për një asfaltim, ku fillon e ku

mbaron, pa një projekt të saktë dhe sa kushton. Nuk e kuptoj si funksionon kjo punë dhe si duhet të diskutojmë, si të votojmë, si të mbrojmë interesat e qytetarëve etj.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Fjala për ju z. Balaj;

Nexhmedin Balaj; Përgëzoi drejtorinë dhe kryetarin për një punë të mirë për krijimin e një projekt buxheti të mirë. Kërkoj sqarime për shtesën tek tabela paga dhe mëditje ku janë minusat kërkoj më shumë sqarime, po kështu kërkoj sqarim edhe për infrastrukturën në Drenas, si dhe për disa gabime që mendoj se janë teknike.

Drejtori Shyqyri Bublaku; Bëri sqarimet e nevojshme për pika të ndryshme.

Adem Bucolli; E kam fjalën për një kërkesë që prej dy vjetësh për tu pajisur me laptopa. Është rasti për ta llogaritur si shpenzim, tek buxheti mallra dhe shërbimet shuma prej 14000 euro. Është kërkesë për të gjithë asambleistat.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Të regjistrohet ndryshimi si kërkesë për pajisje me laptop dhe të planifikohet si shpenzim për asambleistat.

Kryetari Ramiz Lladrovci Të futet në procedurë për ndryshim kjo kërkesë se duhet votuar dhe të realizohet blerja e 30 laptopave. Llogarisni një pjesë të buxhetit për asambleistat se nuk mund të funksionojnë pa buxhet fare.

Kryesuesi Labinot Halilaj; nëse nuk keni gjë tjetër ndonjë shtesë po z. Balaj

Nexhmedin Balaj; Laptopat janë mjete të zyrës që në përfundim të mandatit të dorëzohen.

Kryetari Ramiz Lladrovci; Ju falënderoj për diskutimet tuaja. Nuk kam ndonjë shtesë të veçantë, vetëm ju ftoj për bashkëpunim më të mirë midis nesh.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Atëherë meqë nuk ka diskutime të tjera kalojmë në votim. 18 për, 2 abstenime, 4 kundër, kalon kjo pikë.

Vazhdojmë me votimin e pikës 3; Propozim Vendim për ndryshimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete. Diskutime ska kalojmë në votim. Votojmë; 24 për, kundër ska, abstenim ska. Kalon edhe kjo pikë.

Kalojmë tek Pika 4. Raporti i punës së kryetarit të Komunës për periudhën janar – qershor. Fjalën e ka, po Bylykbashi

Sokol Bylykbashi; Ky raport është një detyrim ligjor i kryetarit. Unë e kam pritur dhe ashtu po del si një e mirë paradoksale. Përmes këtij raporti kemi kuptuar se çfarë kemi votuar. Ashtu siç ka qenë propozim vendimi ashtu po dalin edhe raportet. Domethënë nuk dihet saktësisht se çfarë po punohet në terren. Kemi votuar pa informata të sakta kemi raport pa informata të sakta. dmth na keni mbyllur sytë dhe pastaj kemi votuar. Përshkrimi është i njëjtë siç kanë qene të formuluar kodet. Kjo është vërejtja ime.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Pika 5. Propozim vendim për plotësim - ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë. E hapim për diskutim. Fjala për kryetarin e Komunës Ramiz LLadrovci.

Kryetari Ramiz LLadrovci; Kjo rregullore ka qene debat tek ju. Ka tre gabime teknike dhe kjo ndodh në të gjitha komunat e Kosovës. Nuk ka të bëjë me atë që jam apo nuk jam transparent. Kjo ka të bëjë me afatet ligjore nëse kemi thënë dy ditë është një afat me dhënë përgjigje dhe kanë kaluar 4 ditë dhe kështu me radhë. Veç gabime teknike që nuk janë konsultuar Kolegjiumi për Transparancë i komunave dhe Kolegjimi i Zyrtarëve Ligjor nuk e kanë konsultuar një rregullore të re sipas ligjit që u miratua në qershor. Këto gabime mund ti ndreqim dhe çdo gjë është në rregull.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Meqë s'ka diskutime kalojmë në votim: *për votuan 22 anëtar, kundër s'ka, abstenim s'ka.*

Kalojmë në pikën 6. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Hapim diskutimet, fjalën e ka Bylykbashi.

Sokol Bylykbashi: Para vetes kemi një raport periodik, që e ka formuluar Kryetari për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për të gjeturat e kësaj zyre në Komunën e Drenasit për qeverisjen e vitit të kaluar. Unë dua të flas për diçka që e ka prodhuar këtë raport. Dua të flas për dokumentin e kryetari që ia ka dërguar zyrë së Auditorit të Përgjithshëm. Për këtë kohësa jemi për Kuvendin Komunal janë bërë shumë kritika she shumë akuza që kanë qene të faktuara, pork a pasur edhe kritika që janë bërë pa mbulesë, mirëpo kur flasim për këto dokumente krejt çka mund me thënë është me pranua atë çka shkruajnë të tjerët që janë përgjegjës dhe kredibil dhe është e drejte e secilit me e mbrojtë dhe s'qaru dhe arsyetu. Raporti i Auditorit për qeverisjen komunale për vitin e kaluar e nxjerr Komunën e Drenasit shumë keq. Unë me Raportet e auditimit merrem gaxha moti dhe e kam nisë punën serioze me raportet e Auditorit. Ju më keni vënë në sallë nuk kam folur hiç kam folur diku tjetër por nuk du me fol si kam fillu për shkak se e kam shumë mediale dhe këtë ju e dini.

Po du me përmend veç një të gjetur psh, te rinovimi i kulmit të shkollës "Rilindja" në Dritan ku janë shpenzuar afërsisht 17000 euro. Këto mjete financiare tregojnë dy fakte të mëdhaja që në fakt njëra është shkelje ligjore. Me këtë shkelje i shkon zyrës së prokurimit. Janë shpenzu 17000 euro me vendim të përmbauesit duke tejkaluar bazë ligjore për shpenzimin e parasë publike. Konkretisht janë anashkaluar krej procedurat e prokurimit. Dmth. Thjesht këto mjete janë kontrabanduar. Nuk guxon të shpenzohet asnjë euro pa iu nënshtruar procedurave të prokurimit. Kjo është shkelje që seriozisht duhet të merret Kryetari I Komunës. Çfarë pres unë prej kryetarit të Komunës është kjo: Po e dime që janë shpenzuar 17000 euro për kulmin e një shkolle dhe nuk ka apsolutisht asnjë veprim të procedures së prokurimit. As nuk ka shpallje as nuk ka kontratë as nuk ka konkurs as mbikëqyrje.

Kryesuesi faleminderit fjalën e ka Kryetari.

Kryetari Ramiz LLadrovci; Shqetësimet që po ngre Sokoli janë 100% të vërteta, nuk po bëj ajgare. Sokoli po ngre shqetësime që kanë të bëjnë me vitet 2014-2015 që përmbaruesi na e ka dërguar për ta paguar për keqpërdorim, se bëhet fjalë për kulmin e shkollës në Dobroshevc, të cilën e ka hequr era e madhe dhe kjo ka dasht me u krye me fondet e Drejtorisë së Emergjencave dhe ju keni plotësisht të drejtë, se ky prokurim është kryer pa procedura, prandaj unë skam pasur me i pagu se po të ishte zhvilluar me procedura e kishin paguar jo 17000 euro por 20000, sikurse e kanë shti gypin e ujit prej Ferronikeli deri në Kamenicë, të cilin e kanë bërë me procedura por gypi nuk është.

Kështu Sokol unë krejt këto i kam adresuar në prokurori këto për dijeninë tënde dhe nja katër akuza i ka anëtari yt i ri që ka ardhur në Vetvendosje, për shkelje të pronave në Komunë. I kam adresuar shkeljet tu u nise prej gurëthyesit në Golesh e deri te dhënia e çdo prone në Komunën e Drenasit. Unë e kam një raport të auditimit, që më ka detyruar të bej një komision për t'i adresuar rekomandimet, edhe auditori nuk i ka mirë ndonjëherë se auditori na ka kualifikuar në një pike ku nuk ka të drejtë. Ne kemi marrë auditimin më të mirë të mundshëm, por na ka qit në keq klasifikim të shpenzimeve, për shpenzimet që bëjmë ne me Karitasin për shërbime të qytetarëve tone. Nuk bën me më than me pagu prej shërbimeve kët projekt por duhet me pagu subvencionet. Ku ka parë ai me pagu subvencione për shërbimet e qytetarëve për shërbime 24-orëshe. Jemi munduar me ia spjegu nuk kanë dashtë ta kuptojnë edhe pse e dinë që janë gabim, por deshën me gjet nje pike për më me sulmu për të mos dalë auditimi i mirë 100%. Rezultati i auditimit është më i miri ne rang vendi sepse unë kam marrë grante. Unë po i zbatoj rekomandimet dhe i kemi pas këtu kontrollin e auditimi para një jave dhe po shohim cili rekomandim duhet të implementohet dhe cili jo e kështu me rend.

Mu më bëjnë hajër, shëndet, kur vërejtjet janë me vend, por me fol 10 minuta për 17 000 eurot e 2014, 2015, kur ka ndodhë në shkollën e Dobroshevcit, shkollë që një vit apo dy më parë ishte ndërtuar. Unë edhe këtë e kam kërkuar në prokurori që të hetohet se nuk ka qenë e ndërtuar mirë, sikurse po kërkoj të hetohen krejt ndërtimet pa leje në M 9. Njerëzit po mendojnë se po du me ia rëzu oblektet, Jo, por po lyp se komuna nuk ka zhvilluar procedurat. Psh ka ndërtuar një objekt 10 milin euro dhe është shlyer me një gjobë 300 euro kundërvajtje. Duhet me e çu, se vepër penale është. A e dini pse më luftojnë komandatat! Se ua kam shti maqinat dhe objektet në shirit e s'kanë guxu tre muaj as me i prek. Për këtë po më luftojnë e kanë me më luftu komandantat, por kurgjë s'kan me mujt sepse unë jam i njëjtë për të tanë, po e luan kryet zonja Morina qysh e ka mbiemrin e di ti ata që kishin shkrujt duke i thanë asajta ish dashnores së nipit tim e tash bashkëjeton prej 7-8 muaj. Mbiemrin e dytë, kallxon të dytin. Zotni emri im është që ky, mbiemri është ky se po bëj hajgare me ty, po dmth i kam dencu krejt, të gjitha i kam çue në prokurori Sokol, e kurgja s'kam me lenë krejt i kam me i adresu sepse kjo është epoka me Kadri Veselin, me luftu krimin, korrupsionin, nepotizmin edhe keq përdorimin e çdo zyrtari në komunën tonë.

Kryesuesi; Kundër replikë Bylykbashi.

Sokol Bylykbashi; Zoti Kryetar nëse kjo se unë nuk e di se cilit vit i përket, nëse është vërtetë e vitit 2014-15 atëherë i bie që se ke bërë ti dhe për atë që e ke çuar në prokurori, unë të përgëzoj se njëjtë kisha vepruar edhe unë, por unë se pata këtë informacion se dokumentacionin e mendova se është tani kërkoj falje.

Kryesuesi, fjala për kryetarin.

Kryetari Ramiz LLadrovci; Sokol nuk thash asnjë send me të keq se edhe unë mendova se e dije për cilin projekt po flisje. Mos e merr për keq se thash më bën hajër, shëndet më bën kur më jep një vërejtje. Unë po ju them të qeverisjes teme i kam çuar në prokurori, jo më të qeverisjes para meje. Ma kanë ndërruar, qysh i thonë Flamur pej tokës bujqësore... destinimin e pronave, mi kanë ndru pronarët, më kanë ndru gjithçka, që nuk i kie kryt në vend. E çon te prokurori atë që e bën i thotë prokurorit nuk është nënshkrimi jem, është nënshkrimi i Sokolit, hajt shko prej shpis. 112 000 euro dëme komunës i janë bërë, unë prapë i kam çuar te prokurori e unë s'ndalem. Është ai, që sot e ka në parti Bujupi, i ka nja tre akuza ai.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Meqë është Raport dikasteri nuk miratohet me votim dha ska të tjerë të njoftuar kalojmë tek pika e 7 Prezantimi dhe aprovimi i anëtarëve nga Komisionet e tri Komiteteve Konsultative për konkurrentët e përzgjedhur në bazë të konkurseve. Na po e bëjmë njoftimin ose kryetari i komisionit meqë e kemi këtu.

Kryetari i Komisionit Qendrim Mula; Në emër të komisionit për shqyrtimin e konkursit, zhvillimin e procedurave për formimin e Komitetit Konsultativ, Komiteti për Arsim Kultur Rini dhe Sporte ju njoftoj me listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar intervistën me gojë: Nuhi Nika, Robert Nuha, Gënit Mulaku, Resmie Krasniqi, Zyrafete Morina. Kandidatë e pakënaqur kanë pasur të drejtë ankese tetë ditëve, por asnjë kërkesë nuk është pranuar nga komisioni kështu që ju ftoj për votim.

Kryetari i Komisionit Petrit Sinani; Edhe ne i kemi zhvilluar të gjitha procedurat për formim të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të ambientit, Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale. Formatin e kemi bërë me dy teste. Kandidatë kanë pas me iu nënshtruar pas selektimit natyrisht, testit me shkrim dhe pastaj intervistës me gojë. Pas përfundimit lista e kandidatëve të përzgjedhur nga Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të ambientit, Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale është si vijon; Fitore Shabani, Bastri Gashani, Violeta Ibishi- Bujupi, Burim Dvorani dhe Arbëresha Haziri. Normalisht të gjithë kandidatët e pakënaqur kanë pasur të drejtë ankese tetë ditëve dha ne nuk kemi pasur asnjë kërkesë për tu pranuar nga komisioni prej ditës përfundimtare të shpalljes së listës.

Kryesuesi; Faleminderit ka tjetër, po zonja Tahiraj

Kryetare e Komisionit Haka Tahiraj; Komisioni për shqyrtim të konkursit për zhvillim për formimin e Komitetit Konsultativ, Komiteti për personat me aftësi të kufizuar ju njofton me listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar intervistën me gojë dhe numrin e pikëve.

Përkundër këtyre dy komisioneve, komisioni jon ka shti vetëm një intervistë me gojë, s'ka pasur intervistë me shkrim. Kandidatët që janë pranuar për këtë komitet; Burim Fazliu 79 pikë Ariana Isufi 77 pikë, Arlind Krasniqi 77 pikë, Shemsi Bërbatovci 75 pikë, Jehona Avdyli 70 pikë. Kanë pas të drejtë ankese edhe këto tetë ditë. Ka pasur vetëm një ankesë, që sigurisht u është drejtuar organeve më lartë por me siguri ka marrë përgjigjen pse nuk është në këtë komitet.

Kryesuesi Labinot Halilaj; Ju lutem me që s'ka gjë tjetër kalojmë në votim. Me 23 për, kundër s'ka, abstenim s'ka, kalon edhe kjo pikë.

Pika të ndryshme, ka ndonjë diskutim jo, fjalën e ka Kryetari.

Ramiz Lladrovci; Meqe i kam nja dy sqarime të vogla. Petriti nuk është më ka kritiku për Rregulloren për Transparencë a thënë keqpërdorim keqmenaxhim. E dhash një përgjigje ma herët d.m.th kanë qenë vetëm gabime teknike që e votuat ju nuk ka pasur asgjë se si rezultat i transparencës nuk ka komunë që ka marrë grante më shumë se na. Deshta me sqaru më keni sha më keni kritiku për politizim të arsimit se prej që kam ardh në pushtet kam punu me e depolitizu arsimin. Ftesa e drejtorave të shkollave, që ju ka ardh nga zyrtarja e DKA-së për mes imellave privat e unë që kam qenë jashtë vendi në Gjermani, më vjen keq e kam dërgu në Komisionin Disiplinor. Komisioni Disiplinor i ka marrë masat, ju e dini që unë skam të drejtë që mu përzi në vendimet e Komisionit Disiplinor, por i ka marrë masat duke e dënu me dy rroga nga 50%, por që unë nuk do të pajtohem duke marrë masa më të rrepta, për ata që me i marrë masat konform veprës që e bën. I ka dhënë arsyet e vet se i ka mbet fjala në imell. Mbledhja është e detyrueshme me marrë pjesë në takim me Kryetarin e PDK-së dega Drenas, por që ka qenë sipas saj një gabim teknik. Unë edhe gabimet teknike, ne nuk na liron ligji edhe kur se dina ligjin. Pra gabimet janë të ndëshkueshëm. Unë krejt imellave i shoh se të gjithë zyrtarë janë të detyruar me më shti cc çdo imell tek unë i shoh dhe po isha në Gjermani dhe po ta kisha parë e kisha ndalë.


Mësimdhënësit drejtorët kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete politike gjatë fushatës jo me qenë aktiv, po me ndëgju programet e çdo parti dhe kanë të drejtë dhe mujn me marrë pjesë, por zyrtarë e komunës nuk kanë të drejtë me i ftu drejtorat në një takim të veçantë në parafushatë, prandaj kam marrë edhe masa. Ka edhe çështje të tjera që i kisha dasht me i bisedu por meqenëse sot, për Drenasin komunën tonë është një ditë feste sepse ka kalu buxheti për vitin e ardhshëm dhe projeksionet për vitin 2021-2022. Unë s'po e zgjati më shumë por po ju uroj edhe njëherë për miratimin e buxhetit me vërejtjet që keni bërë dhe ju ftoj që të merrni pjesë në debatet që po i organizon komuna dhe GIZ-i për harta zonale dhe hartat zhvillimore të Komunës që ti këna të përgatitne sa më mirë para se me ardh në seancë, që të mos shtyhem në seancë jo ta bëjmë kështu jo ashtu. Dilni punoni sikur për buxhet që shumica prej juve nuk keni ardh në dëgjime publike as kurrkund, ju lus me marr pjesë në debate me kanë pjesë e proceseve edhe të hartave zhvillimore që do të jenë pjesë për 7 - 8 vjet plus që dotë jenë të nevojshme për komunën tonë dhe për dijeni degradimi i ndërtimeve në komunën tonë që ka shkallu me një vendim të Kuvendit në 2014 në kundërshtim me ligjin e kanë bërë sot që komuna jonë ndërtimet që janë bo të mos ketë as parkingje as e kan bo 99% ndërtim në pronë 6.8 koeficienti që ka qenë në kundërshtim me ligjin e që është 3.8 dhe unë edhe këtë Sokol e kam çu në prokurori, po jo se kam padit

komunën dhe zyrtarët tonë po kam padit ministrinë, se ministria e ka bërë hilen me dikën pej zyrtarëve tonë dhe nuk e ka vazhdu njoftimin që e ka pas nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dikush shkon edhe për këtë tek vendi.

Pas fjalës së kryetarit Kryesuesi deklaroi mbylljen e punimeve të seancës.

Mbledhja përfundoi në orën 12.05

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku-Subashi

